

ALARM 19

ÇFARË NA REKOMANDOI KOMISIONI I VENEDIKUT PËR NDRYSHIMET KUSHTETUESE?

Ministri i drejtësisë Adnan Jashari më 5 gusht 2014 kërkoi mendimin e Komisionit të Venedikut mbi propozim amandamentet (prej XXXIII – XXXIX) të Kushtetutës. Mendimi i cili iu dha qeverisë më 13 tetor nuk është i detyrueshëm, por ja se çfarë premtoi pushteti: „Pushteti ka bindur delegacionin se qëndrimi i Komisionit të Venedikut do të shqyrtohet shumë seriozisht dhe rekomandimet e marra mund të përfshihen në tekstin final të amendamenteve që duhet të dorëzohen në Parlament për miratimin përfundimtar...”

Sa i përket **Propozim amandamentit XXXIII** që rregullon martesën, Komisioni i Venedikut, mes tjerash thekson se nuk e sheh nevojën për këtë dispozitë si kategori kushtetuese: „Gjatë vizitës në vend, delegacioni i Komisionit të Venedikut u informua se në legjislaturë vetëm më ekziston definicion identik për martesën. Sipas kësaj, nga aspekti ligjor, duket se vendosja e këtij definicioni në nivel të parimeve kushtetuese është e panevojshme.” Sa i përket amendamentit të njëjtë, Komisioni shpjegon se kur shteti paraqet dispozita me të cilat definojnë bashkësitë jashtë-martesore, duhet që shteti të jep arsye shumë serioze pse nuk lejon qasje ndaj statusit të bashkësisë jashtë-martesore për çiftet me gjini të njëjtë dhe shton: „Komisioni i Venedikut nuk është i bindur se në këtë rast ekziston një shpjegim i tillë, gjegjësisht nuk u ofrua asnjë argument serioz se pse çiftet e gjinisë së njëjtë nuk meritojnë ndonjë lloj njohje ligjore (të ndryshëm prej statusit tërësisht të pranuar të çiftëve martesore), së paku gjatë vizitës së delegacionit, dhe as që ishin të përfshirë në arsyetimin e përgatitur nga ana e Qeverisë.”

Komenti i parë i Komisioni sa i përket **Propozim amandamentit XXXIV** me të cilin rregullohet zona ndërkombëtare financiare është se ky amendament nuk është qartë i formuluar. Komisioni mendon se: „Si duket, amendamenti XXXIV, ashtu siç është formuluar, jep liri të plotë Parlamentit dhe Qeverisë të krijojnë një organ drejtues me përmbytje të panjohur dhe autorizime të paqarta për miratimin dhe zbatimin e ligjeve brenda kësaj zone”. Veç kësaj, Komisioni shpreh kujdes më të lartë për sovranitetin e shtetit se sa vet Qeveria: „Sipas mendimit të Komisionit të Venedikut, krijimi i zonës ndërkombëtare financiare nuk duhet të rezultojë me marrjen e pushtetit shtetëror nga organet e zgjedhura me procese demokratike në republikën.” Edhe nevoja për propozim amandamentin është vënë nën pikëpyetje: „Arsyetimi për propozimin e amendamentit XXXIV i dhënë nga ana e Qeverisë nuk shpjegon se cila pjesë e skemës për zonën ndërkombëtare financiare duhet të ndryshohet me kushtetutë dhe cilat dispozita specifike nga Kushtetuta pengojnë pushtetin që të krijojë zonë ndërkombëtare financiare nëpërmjet miratimit të ligjeve të reja ose ndryshim të ligjeve ekzistuese.”

Komisioni i Venedikut përshëndet **propozim amandamentin XXXV** (me të cilin rregullohet Enti shtetëror për revizion) dhe **propozim amandamentin XXXVI** (me të cilin definohet pozita e Bankës së RM), por jep rekomandimet në vijim: „...Nëse roli i bankës qendrore definohet në Kushtetutë, atëherë do të ishte e përshtatshme që të pranohet pavarësia e saj për marrjen e vendimeve, si dhe autonomia funksionale me qëllim që amendamenti të lëviz në drejtimin e duhur.” Komisioni kërkoi që

të precizohet më thellësisht pozita e revizorit shtetëror dhe të sigurohen garancione kundër shkarkimit të tij arbitrar.

Sa i përket rregullimit të borxheve buxhetore dhe deficitit në **propozim amandamentin XXXVII**, Komisioni i Venedikut thekson: „Nga pikëpamja ligjore, nuk është e qartë se si në praktikë do të sigurohet përputhshmëri me rregullat për buxhetim. Sipas kësaj, amendamenti nuk qartëson nëse veprimet e Qeverisë dhe Parlamentit, që nënkuptojnë përgjegjshmëri financiare nga shteti, do të jenë lëndë e një lloj kontrolli të caktuar (të mëparshëm ose pasues) dhe cili organ dot të zhvillojë një kontroll të tillë.”

Komisioni i Venedikut i përshëndet disa aspekte të caktuara nga **propozim amandamenti XXXVIII**, por tregon edhe kufizimet serioze sa i përket balancimit të përbërjes së Këshillit gjyqësor: „...raporti i gjykatësve në raport me anëtarët tjerë të Këshillit gjyqësor është 10 me 5. Sipas kësaj, gjykatësit jo vetëm që janë „element thelbësor” ose “shumicë” në Këshillin gjyqësor, por ata paraqesin edhe shumicë të kualifikuar (dy të tretat) dhe sipas kësaj „kanë ndikim vendimmarrës”. Më tutje, Komisioni konsideron se kuotat e drejtpërdrejta etnike mund të shihen edhe si mekanizëm i mundshëm për sigurimin e përfaqësimit ligjësor të bashkësive, edhe përsëri asaj që këto mekanizma duhet të kenë karakter kohor dhe propozon: „Pushteti duhet të mendon nëse duhet të ekzistojnë kuotat etnike në raport me anëtarët tjerë të Këshillit të gjykatësve të zgjedhur nga Parlamenti.”

Zgjerimi i kompetencave të Këshillit Kushtetues nëpërmjet **propozim amandamentin XXXIX** është përshëndetur nga Komisioni me rekomandim për vëmendje: „Komisioni konsideron se themelimi i një ilaçi juridik prej këtij lloji kërkon përgatitje të kujdesshme, miratimin e rregullave procedurale, zhvillimin e metodave të reja për punë, punësim dhe trajnim të nëpunësve shtetëror dhe asistentëve administrativ etj.” Komisioni në fakt kërkoi përmirësimin e amendamentit nga çdo pikëpamje (zgjerimin e shtrirjes së të drejtave; miratimi i ligjeve në gjyqin kushtetues; precizimi i mëturshëm i terminologjisë së amendamentit).

Kurse vlerësimi i Komisionit të Venedikut për kontekstin brenda të cilit bëhen ndryshimet është ky: „Komisioni i Venedikut shënon se amendamentet kushtetuese janë propozuar në mosprezencën e opozitës në Parlament.” „Duke marr parasysh situatën politike aktuale, Komisioni i Venedikut vlerëson se ky nuk është çasti ideal për paraqitjen e amendamenteve kushtetuese. Parimisht, opozita duhet të shpreh mendimin e vet në Parlament, kurse bojkoti është i arsyetuar vetëm në raste të jashtëzakonshme. Nga ana tjetër, procesi i ndryshimit të Kushtetutës kërkoi përkrahje të gjerë politike. Madje, edhe kur koalicioni e ka numrin e duhur të votave për të miratuar këto amendamente në Parlament, kjo nuk e liron Qeverinë nga obligimi që të organizon debat të vërtet dhe gjithëpërfshirës me të gjitha palët e prekura...”



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN OTBORENO
SOCIETY OPICTESTVO
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА